

VENDIM
Nr.916, datë 28.12.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR
VITIN 2012, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore, është 415 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përfshihet, për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, për 10 (dhjetë) punonjësit arkivistë në aparatin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për 5 (pesë) punonjësit në sektorin e pagesave dhe dëmshpërblimeve, në Ministrinë e Financave, nuk zbatohet pika 3 e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

3. Përfshihet për punonjësit e kontraktuar nga Instituti i Statistikave, të cilët do të merren me anketimet, miratimi i numrit të tyre, afatet kohore dhe specifikime të tjera të përcaktohen nëpërmjet një udhëzimi të përbashkët ndërmjet INSTAT-it dhe Ministrisë së Financave.

4. Përfshihet për qendrat e transferimit të teknologjisë në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrotjes së Konsumatorit, për shkak të veçorisë së punës, pagesa e punonjësve të kontraktuar përllogaritet sipas volumit të punës së kryer dhe paguhet sipas preventivit përkatës.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet korente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2012, për njësitë e qeverisjes qendrore. Përfshihet për ALUIZNI-n, QTTB-të dhe 20 (njëzet) punonjësit e SHISH-it, efektet financiare të përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit. Efektet financiare për pozicionet e kontraktuara për periudhën kohore vjetore fillojnë më 1 janar 2012.

6. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet buxhetore sipas lidhjes nr.1, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave detajimin e numrit të punonjësve në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha